



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**V E N D I M**

**Nr. 160, Datë 05/11/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 54, datë 21.05.2019, e z. G. Ç., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se z. G. Ç. ka filluar të punojë pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në datën 31.08.2016, në pozicionin e elektropompistit. Nëpërmjet shkresës nr. 626, datë 12.11.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, ankuesi është njoftuar për takim, në datën 16.11.2018, për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punës. Në vijim, ankuesit i është dërguar shkresa nr.626/3, datë 20.11.2018, nëpërmjet së cilës ai njoftohet mbi vendimin e përfundimit të marrëdhënieve të punës. Sipas shkresës së mësipërme, marrëdhëniet e punës ndërmjet ankuesit dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, do të zgjasin deri në datën 20.01.2019. Referuar Proçesverbalit nr. 626/2, datë 16.11.2018, të mbajtur në takimin e zhvilluar, ndërmjet përfaqësuesve të punëdhënësit dhe z. G. Ç., rezulton se motivacioni për

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

ndërprerjen e marrëdhënieve të punës konsiston në faktin se, ankuesi është skualifikuar në testimin e kryer pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier. Sipas rezultateve të këtij testimi, ankuesi nuk e ka fituar grupin e dytë të sigurimit teknik, të cilin e ka patur më parë, por ka zbritur një grup më poshtë, pra në nivelin e grupit të parë. Një rezultat i tillë e ka penalizuar z. G. Ç., pasi në bazë të Kapitullit 2, të Rregullores “*Mbi sigurimin dhe shfrytëzimin teknik për impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike*”, përcaktohet se punonjësi i shfrytëzimit të hidrovorit duhet të ketë grupin e tretë të sigurimit teknik. Në këto kushte, ankuesit i është hequr e drejta, të punojë në detyrën e mëparëshme. Për sa më sipër, ankuesi pretendon se në datën 19.06.2018, ka pësuar një aksident, nga ku ai ka pësuar një frakturë të krahut dhe si pasojë ai nuk ka qenë i aftë për të kryer testimin, i cili është zhvilluar në muajin korrik 2018. Në këtë kontekst, ankuesi pretendon se është diskriminuar, për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 54, datë 21.05.2019, së z. G. Ç., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, me shkresën nr. 774/1, datë 23.05.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
  - 1.** Kopje e kontratës dhe librezës së punës së ankuesit G. Ç.;
  - 2.** Kopje e urdhërit të emërimit të ankuesit G. Ç., në pozicionin e elektropompistit, pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier;
  - 3.** Praktika e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin, ku të përfshihen: Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Vendimi për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, procesverbali i takimit, etj.

---

<sup>2</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

4. Informacion nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore. Nëse po, të përcillen kopje të akteve përkatëse;
  5. Kopje të vlerësimeve në punë të ankuesit, përgjatë viteve, që ka punuar pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier;
  6. Informacion mbi datën, kur është realizuar testimi i punonjësve, ku të reflektohet numri i punonjësve, që mori pjesë në testim. Të përcillet pranë Komisionerit, lista e tyre emërore, ku të pasqyrohet pozicioni i tyre, i punës, rezultatet në testim, si dhe kualifikimi para dhe pas testimit;
  7. Informacion mbi periodicitetin e kryerjes së testimeve të tilla, për pozicionin e punës “elektropompist”, si dhe të përcaktohet akti administrativ, që e përmban një parashikim të tillë;
  8. Informacion mbi numrin e testimeve të tilla, të cilave ankuesi i është nënshtruar, që prej momentit të punësimit pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, si dhe rezultatet që ai ka patur në këto testime;
  9. Informacion, nëse ankuesi ka qenë me raport të paaftësisë së përkohëshme në punë, në ditën e testimit;
  10. Kopje e raporteve të paaftësisë së përkohëshme në punë të ankuesit të depozituara pranë punëdhënësit, përgjatë periudhës 01.06 – 31.08.2018.
  11. Informacion, nëse ankuesi ka paraqitur paraprakisht kërkesë me shkrim pranë punëdhënësit, ku të kërkohet mospjesëmarrje në testim, për shkak të pamundësisë së tij shëndetësore;
  12. Numri i përgjithshëm i punonjësve, që punojnë në pozicionin elektropompist, sikurse ankuesi, pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier;
  13. Kopje e Dëshmisë së Kualifikimit të Sigurimit Teknik të ankuesit dhe të gjithë punonjësve, që punojnë në pozicion të njëjtë pune me të, para dhe pas kryerjes së testimit.
  14. Kopje e strukturës organike të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier;
  15. Kopje e Rregullores “*Mbi sigurimin dhe shfrytëzimin teknik për impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike*”.
  16. Informacion mbi numrin e punonjësve “elektropompistë”, që si pasojë e skualifikimit në testim, iu janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, kopje te praktikave përkatëse për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për këta punonjës;
1. Në përgjigje të shkresës nr. 774/1, datë 23.05.2019, së Komisionerit, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, dërgoi shkresën nr. 272/1, datë 14.06.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se z. G. Ç. ka paraqitur pranë këtij institucioni, raportin mjekësor, ku evidentohet periudha e paaftësisë së përkohëshme në punë, që i përket datave 19.06.2018-02.07.2018 dhe 03.07.2018-19.07.2018. Testimi i punonjësve është kryer nga firma HTM sh.p.k.,

fituese e procedurës së prokurimit, që Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier ka zhvilluar, për të kontraktuar një subjekt të licencuar për zhvillimin e testimeve të tilla dhe pajisjen e punonjësve me Kartela të Sigurimit Teknik. Një testim i tillë kryhet për shkak të natyrës që paraqet pozicioni i punës së elektropompistëve, të cilët punojnë në Hidrovore, në prezencë të rrymave elektrike.

Për sa më sipër, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier e bën me dije KMD-në, se testimi është kryer në përputhje me Urdhërin nr. 287, dtë 12.06.2006, e Ministrit të Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të kullimit me elektropompa aksioale, hidrovoret”*”, Kapitulli II, F.6, *“Për testimin e punonjësve të Hidrovorëve”*, ku parashikohet: *“Punonjësit e shfrytëzimit të hidrovorëve instruktohen dhe kalojnë në provim për njohuritë e sigurimit teknik e mbrojtjes në punë para një komisioni një herë në vit”*. Në bazë të dispozitës së sipërcituar, testimi i punonjësve kryhet në mënyrë periodike një herë në vit. Testimi i punonjësve është zhvilluar në datën 16.07.2018, ku ankuesi ka marrë pjesë dhe ka firmosur në listëprezencën përkatëse.

Megjithëse ka qenë me raport mjekësor, pasi është njoftuar për zhvillimin e testimit, z. G. Ç. është paraqitur në testim, me vullnetin e tij, duke qenë se ka qenë në ditët e fundit të paftësisë së përkohshme në punë. Ai nuk ka paraqitur pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier ndonjë kërkesë për mospjesëmarrje në testim, për shkak të kushteve të tij shëndetësore.

Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Fier sqaron se në mbështetje të Kapitullit II, të Rregullores së sipërpërmendur përcaktohet se punonjësi i shfrytëzimit të hidrovorit duhet të ketë grupin e tretë të sigurimit teknik. Mospasja e kësaj kategorie heq të drejtën këtyre punonjësve të punojnë në këto stacione. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin nuk është e menjëherëshme, por janë respektuar parashikimet ligjore të dispozitave përkatëse të Kodit të Punës. Libreza e punës dhe Kopjet e Dëshmisë së Sigurimit Teknik janë tërhequr nga ankuesi dhe disponohen prej tij. Njëkohësisht, në shkresën nr. 272/1, datë 14.06.2019, të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier sqarohet se ndaj ankuesit nuk është marrë asnjë masë disiplinore, ndërkohë që nuk ka vlerësime pune të dhëna për të, pasi vendi i punës së ankuesit nuk bën pjesë në shërbimin civil dhe nuk mbulohet nga legjislacioni përkatës.

Sikurse për z. G. Ç., praktika për zgjidhjen e kontratës së punës, me të njëjtin motivacion, është zbatuar edhe ndaj 2 punonjësve të tjerë, përkatësisht ndaj z. M. L. dhe z. N.K., të cilët rezultojnë gjithashtu në kategorinë e parë të Sigurimit Teknik.

Bashkëlidhur shkresës nr. 272/1, datë 14.06.2019, të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier u dërguan kopje të dokumentacionit të kërkuar nga KMD.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 14.08.2019, ora 12:00**, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi dhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, i cili depozitoi aktin e përfaqësimit, përkatësisht Autorizimin nr. 360/1, datë 13.08.2019, lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

Ankuesi parashtroi sërisht pretendimet e tij për diskriminim për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, duke theksuar faktin se një ditë para datës së caktuar për testim, është njoftuar mbi këtë fakt, nga ana e punëdhënësit. Ai theksoi faktin se në kushtet kur ai kishte pësuar frakturë, në njërin prej gjymtyrëve të sipërme, në momentin e njoftimit është shprehur se nuk mund të marrë pjesë në testim, pasi nuk ishte i aftë nga ana shëndetësore. Pavarësisht sa më sipër, ai është paraqitur dhe ka marrë pjesë në testim. Por, duke qenë se e kishte të pamundur të shkruante, ai ka kërkuar të rítestohet. I pyetur mbi mënyrën se si zhvillohet testimi, ankuesi sqaroi se ky testim zhvillohej me shkrim dhe verbalisht. Ai theksoi faktin se në kushtet kur nuk është ndjerë mirë nga ana shëndetësore, nuk u është përgjigjur mirë pyetjeve të bëra gjatë testimit. Nga 8 punonjës që bënë pjesë në sektorin ku punon ankuesi, vetëm ai nuk ka arritur të kalojë këtë testim.

Përfaqësuesi me autorizim i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier u shpreh se punonjësit e hidrovoreve i nënshtroheshin testimit një herë në vit. Testimi zhvillohej nga firma fituese e tenderit dhe jo nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier. Në kushtet kur, pjesëmarrja në testim është diçka e mirë për punonjësin, pra është në favorin e tij të testohet dhe çertifikohet, ankuesi është njoftuar që të marrë pjesë në testim. Pjesëmarrja në testim është pranuar në mënyrë konsesuale nga ana e tij dhe ankuesi nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim, ku të kërkonte përjashtim nga pjesëmarrja në testim për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Punonjësi ka nënshkruar procesverbalin e prezencës në testim. Pas kryerjes së testimit, punonjësi ka rezultuar në kategorinë e parë, ndërkohë që punonjësit e hidrovorëve duhet të kenë kategorinë e tretë. Përveç ankuesit, edhe punonjës të tjerë që rezultuan në kategorinë e parë pas kryerjes së testimit, u janë zgjidhur marrëdhëniet e punës. Përfaqësuesja e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier theksoi faktin se punonjësit lajmërohen 2-3 ditë para datës së caktuar për testim dhe nuk kanë nevojë për përgatitje të veçantë, pasi ata testohen mbi punën e tyre të përditëshme. E pyetur në lidhje me vlerësimet në punë të ankuesit, përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier u shpreh se nuk ka vlerësime të tilla, pasi këta punonjës nuk kanë status të posaçëm.

Të pyetur në lidhje me përmbajtjen e pyetjeve në testim, ankuesi u shpreh se për dy vjet rresht pyetjet e testimit kanë qenë të njëjta. Përjashtim bënte testimi i vjetshëm, ku kishin shtuar 2 pyetje të reja. Ai u shpreh se kishte qenë 1 muaj me raport paaftësie të përkohshme në punë. E pyetur nëse testimi mund të zhvillohej vetëm verbalisht për ankuesin, në kushtet kur ai ishte i pamundur për ta zhvilluar

me shkrim, përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier u shpreh se informacionin për këtë çështje do ta dërgonte me shkrim në vijim të seancës dëgjimore. E pyetur se si është proceduar në rastet e testimave paraardhëse, ku punonjës të tjerë për arsye të ndryshme nuk kanë marrë pjesë në testim, si dhe si mbi mënyrën se si investonte institucioni në rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të tij, sërisht përfaqësuesi i institucionit u shpreh se informacionin do ta dërgonte me shkrim.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier dërgoi shkresën nr. 1301, datë 02.09.2019, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin, mbi ato çështje të cilat mbetën të pasqaruara në seancë dëgjimore.

Lidhur me pyetjen e drejtuar nga përfaqësuesit e KMD-së, nëse ka patur raste të ngjashme të mosparaqitjes së punonjësve në ditën e testimit dhe cilat janë masat e mëtejshme që janë ndërmarrë për këta punonjës, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier informon se gjatë procesit të testimit ka patur punonjës që nuk janë paraqitur ditën e testimit. Këta punonjës, në ditën e testimit, kanë qenë në turn dhe për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë, pasi nuk mund të linin punën nuk janë paraqitur në testim. Këta punonjës i janë nënshtruar testimit në ambientet e kompanisë në një ditë tjetër.

Lidhur me pyetjen e drejtuar nga përfaqësuesit e KMD-së, nëse ankuesi ka ngritur pretendime në ambientet e zhvillimit të testimit për pamundësinë e zhvillimit të testit, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier sqaron se nisur nga konsulta me personat, që kanë qenë prezent në ditën e testimit, ankuesi rezulton se nuk ka paraqitur asnjë pretendim se ka qenë në pamundësi të zhvillimit të testimit. Grupi i inxhinierëve përkundrazi e ka pyetur përse është paraqitur dhe ka qenë ankuesi ai që ka këmbëngulur të zhvillojë testin, duke mos dashur të shkojë një ditë tjetër në ambientet e firmës në qytetin e Durrësit për ta zhvilluar atje testimin.

Lidhur me pyetjen e drejtuar nga përfaqësuesit e KMD-së, nëse institucioni zhvillon trajnime për ngritjen profesionale të punonjësve, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier informon se stafi i inxhinierëve i instrukton punonjësit e hidrovoreve në ambientet e punës, mbi mënyrën e përdorimit të pajisjeve dhe mbi rregullat e sigurimit teknik. Gjithshtu në ambientet e punës, ndodhet e afishuar, stenda e instruksioneve të sigurimit teknik.

Lidhur me pyetjen e drejtuar nga përfaqësuesit e KMD-së, se si është punësuar punonjësi dhe cilën kategori të sigurimit teknik ka patur, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier informon se punonjësi është punësuar mbi bazën e rregullores së Hidrovoreve, e cila kondicionon për këtë pozicion pune arsimin profesional elektrik/mekanik ose arsimin e mesëm të përgjithshëm. Gjithashtu, punonjësi duhet të ketë kategorinë e tretë të sigurimit teknik, të përcaktuar në Rregulloren “Për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të kullimit me elektropompa aksiale”, Kapitulli II.

Në fillim të punësimit, ankuesi është mbajtur në periudhë prove nën mbikqyrjen e një punonjësi me përvojë dhe njohuri të thelluara të sigurimit teknik. Pas periudhës së provës, punonjësi i është nënshtruar testimi të sigurimit teknik dhe ka rezultuar se i përket grupit të dytë. Gjatë gjithë periudhës së punës ka mbajtur kategorinë e dytë, duke tentuar disa herë të marrë kategorinë e III të sigurimit teknik, por ka dështuar. Në kushtet kur, në testimin e fundit, z. G. Ç. ka rezultuar në kategorinë e I, vijimi i punës për të në hidrovore, si objekte të rëndësishme të veçantë, ishte i pamundur. Bashkëlidhur shkresës, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier ka dërguar Aktmarrëveshjen me firmën që ka zhvilluar testimin.

2. Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesi G. Ç. dërgoi pranë Komisionerit shkresën nr. 774/4, datë 29.08.2019, nëpërmjet së cilës ritheksohen edhe një herë pretendimet e tij, mbi çështjen në shqyrtim, si dhe kërkohet që KMD të analizojë të gjithë kategoritë e punëtorëve të tjerë dhe aftësisë së tyre për të fituar kategoritë përkatëse dhe nëse ata i përmbushnin kriteret.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 54, datë 21.05.2019, e z. G. Ç., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Në ankesën nr. 54, datë 21.05.2019, së z. G. Ç., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të hetimit administrativ rezulton se z. G. Ç. është emëruar në datën 01.09.2016, në pozicionin e elektropompistit në hidrovore, pranë Bordit të Kullimit Fier, nëpërmjet Urdhërit nr. 678, datë 31.08.2016, të Drejtorit Rajonal. Marrëdhënia e punës ndërmjet palëve është rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës. Referuar dokumentacionit të depozituar nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier rezulton se ankuesi ka punuar pranë Hidrovorit të Darzezës.

Mbështetur në Urdhërin nr. 287, dtë 12.06.2006, e Ministrit të Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të kullimit me elektropompa aksiale, hidrovoret””, Kapitulli II, F.6, “Për testimin e punonjësve të Hidrovorëve”, parashikohet: “Punonjësit e shfrytëzimit të hidrovorëve instruktohen dhe

*kalojnë në provim për njohuritë e sigurimit teknik e mbrojtjes në punë para një komisioni një herë në vit*". Në bazë të dispozitës së sipërcituar, testimi i punonjësve kryhet në mënyrë periodike një herë në vit. Në mbështetje të Kapitullit II, të Rregullores së sipërpërmendur punonjësi i shfrytëzimit të hidrovorit duhet të ketë grupin e tretë të sigurimit teknik. Mungesa e kësaj kategorie heq të drejtën këtyre punonjësve të punojnë në këto stacione. Ankuesi ka punuar për 1 vit në periudhë prove, nën mbikqyrjen e një punonjësi me përvojë. Në vijim, në testimin e kryer në vitin 2017, Z. G. Ç. ka kaluar nga kategoria e parë në kategorinë e dytë, fakt që dëshmon për një përparim të tij, për sa i përket njohurive të sigurimit teknik e mbrojtjes në punë.

Për vitin 2018, testimi i punonjësve është zhvilluar në datën 16.07.2018, datë në të cilën ankuesi ka qenë me raport paaftësie të përkohëshme në punë, pasi në muajin qershor 2018, z. G. Ç. ka pësuar një aksident, si pasojë e së cilit ka patur frakturë të njëjës prej gjymtyrëve të sipërme. Ankuesi ka qenë me raport paaftësie të përkohëshme në punë përgjatë datave 19.06.2018 – 03.07.2018<sup>3</sup> dhe 03.07.2018 – 19.07.2018<sup>4</sup>.

Mbështetur në procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 14.08.2019, si dhe shkresave të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, rezulton se punëdhënësi e ka njoftuar ankuesin, në lidhje me zhvillimin e testimit, një ditë para zhvillimit të tij. Ankuesi është paraqitur në testim, megjithëse ka qenë në ditët e fundit të raportit mjekësor<sup>5</sup>. Referuar akteve të depozituara në cilësinë e provës rezulton se ankuesi ka marrë pjesë në testim dhe ka firmosur në listëprezencën përkatëse, si dhe nuk rezulton të ketë paraqitur kërkesë me shkrim, ku të kërkonte përjashtim nga pjesëmarrja në testim për shkak të gjendjes së tij, shëndetësore. Testimi është zhvilluar me shkrim dhe verbalisht. Pavarësisht sa më sipër ankuesi ka rënë në kategori, duke u zhvendosur nga kategoria II, të cilën e kishte fituar në vitin 2017, në kategorinë e parë. Sikurse u përmend edhe në seancë dëgjimore, pyetjet e testimit kanë të bëjnë me rregullat e sigurimit teknik në punë, pra me rregullat që punonjësit e hidrovoreve ndjekin çdo ditë gjatë punës së tyre. Këto pyetje janë përafërsisht të njëjta pothuajse në çdo testim të kryer.

Komisioneri vë në dukje faktin se ankuesi nuk ka paraqitur prova, nëpërmjet së cilave të provojë se ka marrë pjesë në testim si rrjedhojë e trysnisë dhe presionit psikologjik të ushtruar nga punëdhënësi. Ndërkohë që, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, në kushtet kur në bazë të nenit 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i

---

<sup>3</sup>Referuar Raportit për paaftësi të përkohëshme në punë nr. Regj. 2228, datë 25.06.2018, të lëshuar nga Spitali Rajonal Fier.

<sup>4</sup>Referuar shkresës nr 467/1, datë 11.07.2018, të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

<sup>5</sup>Testimi është zhvilluar në datën 16.07.2019, ndërkohë që ankuesi ishte i aftë për t'u kthyer në punë në datën 19.07.2019.



ndryshuar)<sup>6</sup>, ka patur barrën e provës, për të provuar se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të disfavorshme ka theksuar faktin se pjesëmarrja e z. G. Ç. ka qenë konsensuale, pa asnjë një lloj imponimi nga ana e punëdhënësit, si dhe nga ana e ankuesit nuk është depozituar asnjë kërkesë me shkrim, ku të kërkohej përjashtimi nga testimi, i cili mund të zhvillohej edhe një ditë tjetër, në ambientet e firmës që e zhvillonte këtë testim, për ata punonjës, që e kishin të pamundur të testoheshin në datën 16.07.2018. Njëkohësisht, punëdhënësi ka depozituar Aktmarrëveshjen e lidhur me firmën e kontraktuar, për të zhvilluar testimin, nëpërmjet së cilës rezulton se matja e njohurive në fushën e sigurimit teknik dhe vlerësimi i punonjësve do të kryhet pikërisht nga kjo firmë.

Komisioneri gjykon se pavarësisht sa më sipër, në kushtet kur ankuesi ka qenë ende me raport paaftësie në punë dhe pavarësisht kësaj, është paraqitur për t'u testuar para Komisionit përkatës të Ekzaminimit, ishte detyrë e këtij Komisioni dhe sidomos punëdhënësit, ta informonte z. G. Ç., se testimin mund ta kryente në një ditë tjetër pranë firmës dhe ta përjashtonte atë nga testimi i datës 16.07.2018. Nga shqyrtimi administrativ i kësaj ankese rezultoi se në asnjë rast ankuesi nuk është informuar nga punëdhënësi, mbi faktin se testimin mund ta kryente në një ditë tjetër.

Pas daljes së rezultateve të testimit, punëdhënësi i ka dërguar ankuesit shkresën nr. 626 prot., datë 12.11.2018, ku njoftohet për diskutim të marrëdhënies së punës, takim i cili u zhvillua në datën 16.11.2018. Referuar procesverbalit të takimit citohet: *“...punëdhënësi mendon të shkëpusë marrëdhënien e punës me ju për shkak të mungesës së kategorisë minimale që kondicionon vendi i punës. Mosnjohja e rregullave bazë të sigurimit teknik në Hidrovore si objekte të rëndësishme të veçantë pengon mbarëvajtjen në punë dhe vë në rrezik pajisjet dhe jetën e punonjësve.*

*Arsyet e punëmarrësit: Arsyeja ime është se në datën 19.06.2018 pësova një aksident dhe në ditën e provimit nuk isha në gjendje. Mora pjesë për të mos munguar. Kërkoj ritestim.”*

Në vijim të takimit të sipërpërmendur, punëdhënësi i ka dërguar ankuesit shkresën nr. 626/9, datë 20.11.2018, ku informohet mbi vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës.

---

<sup>6</sup> Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: *“2.Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”*

Për sa më sipër, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier e ka informuar Komisionerin se punëdhënësi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës edhe me dy punonjës të tjerë, që në përfundim të testimit janë kategorizuar në kategorinë e parë të sigurimit teknik, sikurse ankuesi. Këta punonjës janë përkatësisht z. M. L. dhe z. N.K. Për këta dy punonjës, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier ka depozituar në cilësinë e provës edhe praktikatat përkatëse për zgjidhjen e kontratave të punës.

Për të verifikuar sa më sipër, Komisioneri iu referua proçeverbaleve përkatëse pas testimit të kryer për punonjësit e hidrovoreve. Mbështetur në Proçesverbalet nr. 135, datë 18.07.2018<sup>7</sup>, rezultoi se përveç punonjësve të sipërpërmendur, pas kryerjes së testimit janë kategorizuar në kategorinë I-rë të sigurimit teknik edhe punonjësit K. L. dhe L. B., për të cilët Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier nuk ka depozituar informacion mbi procedurën, që është ndjekur ndaj tyre. Ky fakt krijon dyshimin e arsyeshëm, se këta punonjës janë mbajtur në punë.

Në këtë kontekst, në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri krijon bindjen e arsyeshme se z. G. Ç. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Në ankesën nr. 54, datë 21.05.2019, e z. G. Ç., pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

1. “Gjendja shëndetësore” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione

---

<sup>7</sup> Rezultojnë dy fletë proçeverbalesh me numër dhe datë të njëjtë, ku janë kategorizuar punonjës të ndryshëm.

*gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, Komisioneri gjykon se ky konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe janë depozituar fakte dhe prova të mjaftueshme nga ankuesi, që provojnë gjendjen e tij shëndetësore.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Në ankesën nr. 54, datë 21.05.2019, e z. G. Ç., pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese Komisioneri konstatoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier. Në kushtet kur, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, presupozohet që gjendja e tij shëndetësore të jetë shkak, për të cilin z. G. Ç., i është zgjidhur kontrata e punës nga ana e punëdhënësit.

Diskriminimi në vetëvete karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk e posedon karakteristikën e mbrojtur.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezultoi se edhe punonjës të tjerë, që punonin në hidrovoret e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, të cilët, pas kryerjes së testimit ishin kategorizuar në kategorinë e parë të sigurimit teknik, janë larguar nga puna, pavarësisht se gjendja e tyre shëndetësore ishte e ndryshme nga ajo e Z. G. Ç.. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë e disfavorizues të punëdhënësit me gjendjen shëndetësore të ankuesit G. Ç..

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: “*Diskriminimi*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Në mungesë të një lidhjeje të tillë, ndërmjet këtyre dy elementëve thelbësorë, që përcaktojnë diskriminimin e ndodhur, Komisioneri gjykon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 e 13, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. G. Ç., për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Fusha – punësim  
Shkak – gjendja shëndetësore